



## BULETIN

3- MUJOR/NR.

JANAR - MARS 2007

PASQYRA E TITUVJE

KRYESORË :

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE
2. OFRIM EKSPERTIZË NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TU
3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUËSE DHE EDUKUESE NË FUSHËN PENITENCIARE
4. ADRESIMI I PROBLEMEVE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHITËTËRORE
5. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E EDUKIMIT TË PUBLIKUT
6. VEPRIMTARI NDËRGJEGJËSUESE DHE EDUKUESE
7. AVOKIMI NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
8. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS
9. RRITJA E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE DHE AKTORËT SHITËTËRORE
10. PROJEKTE TË REJA
11. PUBLIKIME OË DO TË BOTOHEN SË SHPEJTI

Përgatiti buletin: av. *Klesta Alikaj*

*Juriste/koordinatore projekti*

Redaktimi letrar: *Marie Mato*

# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## BULETIN

Janar - mars 2007

*Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it (CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT)*

### Vëzhgimi i procesit zgjedhor

Gjatë periudhës janar-shkurt 2007, KSHH-ja ka vëzhguar fushatën zgjedhore dhe procesin e votimit të datës 18 shkurt 2007, në Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe në komunat e Dropullit, Cepos, Cepos dhe Odries, në Belsh, Cërrik, Shirgjan, Bradashesh, Labinot Fushë, Drenovë, Gjergjan, Spitalë dhe Shkozet.

*Vazhdon në faqen 2*

### KSHH-ja dhuron libra për të dënuarit

Për të dhënë ndihmesën e vet në përmirësimin e kushteve të jetesës në institucionet e paraburgimit dhe në burgje, në pasurimin dhe krijimin e bibliotekave të këtyre institucioneve si edhe në arsimimin dhe formimin kulturor të personave të dënuar me heqje lirie, bibliotekave të institucioneve të paraburgimit dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimit KSHH-ja u dhuroi një sasi të konsiderueshme prej **1814 librash**<sup>1</sup>.

*Vazhdon në faqen 4*

### FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE “TË GJITHË TË NDRYSHËM – TË GJITHË TË BARABARTË” – JAVA KUNDËR DISKRIMINIMIT, 19-24 MARS 2007

Në kuadër të ditës ndërkombëtare kundër diskriminimit në përgjithësi dhe diskriminimit racia në veçanti, KSHH-ja ndërmori disa veprimtari ndërgjegjësuese me brezin e ri me qëllim edukimin dhe sensibilizimin për të parandaluar rastet e diskriminimit të hapur ose të fshehtë në shoqëri.

*Vazhdon në faqen 9*

*Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:*

**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**

**Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1,**

**Ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752**

**web-site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

**Tel: 04 233671**

**Cel: 068 20 23699;**

**E-mail:**

## **1. Respektimi i të drejtave të qytetarëve**

### **1.1 Misione vëzhgimi**

Në kuadër të projektit ‘Për respektimin e të drejtave të emigrantëve dhe të personave të kthyer’ janë organizuar vëzhgime në disa pika kufitare për të parë respektimin e të drejtave të personave që kalojnë në pikat e kalim-kufirit. Konkretisht, më:

- ▶ 18-19 janar 2007 u vëzhguan pikat kryesore të kalimit kufitar me Malin e Zi, përkatësisht në pikat e kalimit kufitar: Hani i Hotit (Malësi e Madhe ), Muriqan ( Shkodër) dhe në portin e Shëngjinit (Lezhë).
- ▶ 29-30 janar 2007, objekt vëzhgimi ishin pikat e kalimit kufitar të Vlorës (porti) dhe të Himarës (porti). Në pikën e kalimit kufitar të portit të Vlorës problemet kryesore i përkitnin infrastrukturës. Policia kufitare në port kishte mungesa në mjediset e nevojshme për të intervistuar personat e kthyer dhe për të kryer procedurat e saj.
- ▶ 7-9 shkurt 2007 u krye vëzhgimi në pikat kryesore të kalimit kufitar të Sarandës, përkatësisht në pikën e kalimit kufitar në Qafë- Bllatë, Livadhja dhe në portin e Sarandës.
- ▶ 12-14 mars 2007 u kryen vëzhgime në pikat kryesore të kalimit kufitar me Maqedoninë, përkatësisht në pikat e kalimit kufitar: Goricë (Korçë), Tushemisht dhe Qafë-Thanë (Pogradec).

Problemet e dala nga vëzhgimet kishin të bënin me infrastrukturën e pikave të kalim tëkufirit, trajtimin e shtetasve nga ana e policisë kufitare etj. Për më shumë, vizitoni faqen web të KShH-së: <http://ahc.org.al/kshh/emigrantet/emigrantet2.html>

Përfundimet dhe rekomandimet e dala nga vëzhgimet u janë dërguar autoriteteve shtetërore kompetente.

### **1.2 Vëzhgimi i procesit zgjedhor**

Gjatë periudhës janar-shkurt 2007, KShH-ja vëzhgoi fushatën zgjedhore dhe procesin e votimit të 18 shkurtit 2007, në Tiranë, Gjirokastër, Fier, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe në komunat e Dropullit, Cepos, Cepos dhe Odries, në Belsh, Cërrik, Shirgjan, Bradashesh, Labinot Fushë, Drenovë, Gjergjan, Spitallë dhe Shkozë. Objekti kryesor i vëzhgimeve ishin listat e zgjedhësve, interesi i votuesve për listat e zgjedhësve, ushtrimi i së drejtës së ankimit për parregullsitë në lista, respektimi i normave zgjedhore gjatë procesit të votimit dhe të numërimit etj.

Për vëzhgimin e zgjedhjeve vendore të 18 shkurtit 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit akreditoi 150 vëzhgues afatgjatë të cilët vëzhguan aspekte të procesit parazgjedhor, fushatën zgjedhore, procesin e votimit dhe atë të numërimit të votave në Tiranë, Durrës,

Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan dhe disa komuna të vendit. Për më shumë lidhur me përfundimet e vëzhgimeve të fushatës zgjedhore, të procesit të votimit dhe të numërimit të votave, mund të lexoni në adresën: <http://ahc.org.al/kshh/zgjedhjet/raporteZGJEDHJET.html>

### **1.3 Respektimi i të drejtave të të parburgosurve**

Në kuadër të misionit të tij mbrojtës dhe sensibilizues për të drejtat e njeriut, gjatë muajve mars-maj 2007, KShH-ja do të realizojë një raund misionesh monitorimi në burgje dhe në vendet e parburgimit. Qëllimi i tyre është vëzhgimi i situatës së respektimit të të drejtave të të parburgosurve pas kalimit të vendeve të parburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i problemeve që has administrata e burgjeve dhe i nevojave për përmirësimin e këtij procesi. Në përfundim të vëzhgimeve, KShH-ja do t'ua paraqesë rekomandimet e tij institucioneve përgjegjëse për përmirësimin e situatës së të drejtave të të parburgosurve në këto institucione.

## **2. OFRIM EKSPERTIZË NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TIJ**

### **2.1 KShH-ja i adreson letra KQZ-së për çështje të ndryshme që lidhen me procesin zgjedhor**

- ▶ Me qëllim që të respektohej e drejta e votuesve dhe për një respektim më të mirë të ligjit, KShH-ja i drejtoi një letër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet së cilës shprehte shqetësimin për keqkuptimet dhe cenimin e ligjit që mund të shkaktonin dy udhëzimet e Ministrisë së Brendshme dhe shkresat e dërguara nga z. Ferdinand Pone në adresë të zyrave të gjendjes civile për pajisjen e qytetarëve me certifikata për votime.
- ▶ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, më 16 janar 2006, i dërgoi një letër z. Çlirim Gjata, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me marrjen e masave nga KQZ-ja për pajisjen me 2 qirinj të komisioneve të zgjedhjeve. KShH-ja shprehu shqetësim për këtë problem dhe sugjeroi se dy - tri ditë para ditës së zgjedhjeve, ditën e votimit dhe gjatë gjithë kohës së numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve në bazë KZQV-je energjia elektrike nuk duhet të mungojë.
- ▶ Për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në prag të ditës së votimit, gjatë ditës së votimit dhe gjatë numërimit të votave, më 19 janar 2007, KShH-ja i dërgoi një letër z. Genc Ruli, ministër i Ekonomisë; z. Andi Beli, drejtor i KESH-it dhe, për dijeni, z. Sali Berisha, Kryetar i Këshillit të Ministrave, lidhur me marrjen e masave për furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Nisur nga vështirësitë për furnizim të pandërprerë me energji elektrike, në këtë letër KShH-ja sugjeron marrjen e masave për të siguruar ndriçim të pandërprerë 2-3 ditë para ditës së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve dhe 2-3 ditë pas datës së zgjedhjeve, veçanërisht në ato zona apo njësi ku zhvillohen proceset zgjedhore dhe ku do të bëhet numërimi i votave.

- ▶ Në datën 16 janar 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i dërgoi një letër z. Çlirim Gjata, Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe z.Sali Berisha, Kryetar i Këshillit të Ministrave, lidhur me realizimin në praktikë të ankimimit të zgjedhësve nëse emrat e tyre nuk gjenden në listë ose mbarin gabime. Në ndryshimet që iu bënë Kodit zgjedhor me ligjin nr. 9676, datë 13.1.2007, nuk thuhet gjë për rolin e gjykatave në rastin kur një shtetas nuk gjendet në listat e zgjedhësve. Në këtë letër KShH-ja shprehte shqetësimin e tij për këtë problem dhe sugjeronte që, në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, të jepej orientimi për gjykatat e rretheve gjyqësore në lidhje me dokumentet që duhet të paraqesë një shtetas, emri i të cilit nuk gjendet në listat e zgjedhësve, për të vërtetuar të drejtën për të votuar.
- ▶ Më 19 janar 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i dërgoi një letër z. Genc Pollo, ministër i Arsimit dhe i Shkencës, z. Shezai Rrokaj, rektor i Universitetit të Tiranës, si dhe të gjithë rektorëve të universiteteve shtetërore dhe private të tjera lidhur me krijimin e mundësive që studentët të votojnë në vendet e tyre të banimit. Në ndryshimet që iu bënë Kodit zgjedhor, u shfuqizuan të gjitha dispozitat ku bëhet fjalë për regjistrin e përkohshëm dhe, si rrjedhim, edhe për hartimin e listave me zgjedhës me vendqëndrim të përkohshëm.

KShH-ja sugjeroi që të krijohej mundësia të mos caktoheshin provime ose detyrime të tjera mësimore në periudhën 16-19 shkurt 2007, në mënyrë që studentët të votonin në vendet e tyre të banimit, në zyrat përkatëse të gjendjes civile, aty ku ata kishin regjistrin themeltar të banimit.

## **2.2 Takim koordinues për çështjet e minoritetit rom**

Në datën 23 janar 2007, Prezenca e OSBE-së në Tiranë organizoi “Takimin koordinues për çështjet e minoritetit rom”. Takimi u përqendrua në raportimin e aktiviteteve që do të ndërmerren nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet shtetërore për minoritetin rom në zbatim të strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”. Të pranishëm në takim ishin Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësues të organizatave vendëse dhe të huaja që punojnë për minoritetin rom, si dhe përfaqësues nga institucionet shtetërore.

## **2.3 Takim i grupit të punës lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Europës**

Në datën 16 shkurt 2007, në mjediset e Ministrisë së Punëve të Jashtme u organizua një takim pune për zbatimin e pesë rekomandimeve në fushën e të drejtave të njeriut, miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës. Qëllimi i këtij takimi ishte ngritja e një grupi pune i cili do të punojë dhe do të kontribuojë në zbatimin më të mirë të rekomandimeve. Të pranishëm në takim ishin: përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, nga Ministria e Arsimit, nga Ministria e Drejtësisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si dhe nga organizata të tjera që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Në kuadër të këtij takimi,

KShH-ja i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme komentet e tij lidhur me zbatimin e pesë rekomandimeve në Shqipëri.

#### **2.4 Mbledhje e përfaqësuesve të shoqërisë civile në Ministrinë e Punëve të Jashtme**

Më 6 mars 2007, KShH-ja mori pjesë në takimin e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT). Ky takim ishte vazhdimësi e takimeve të zyrës së përfaqësuesit ligjor në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe angazhimit të këtyre të fundit për të dhënë ndihmesën e tyre në zbatimin sa më të shpejtë të këtyre rekomandimeve nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore. Në takim u diskutua për mënyrën e bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile aktive në këtë fushë dhe zyrës së përfaqësuesit ligjor në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Zyra e përfaqësuesit ligjor mori përsipër të paraqesë agjendën e veprimtarive që planifikon të realizojë në këtë fushë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile do të dërgojnë pranë kësaj zyre një përkrahje të shkurtër të profilit të tyre.

#### **2.5 Takim i grupit të punës për sistemin e shërbimit avokator falas**

Në datën 16 mars 2007, Klinika Ligjore për të Miturit organizoi takimin e radhës të grupit të punës për diskutimin e projektraportit “Për sistemin e shërbimit avokator falas”. Në këtë takim përfaqësuesja e KShH-së, zj.E.Saliu, dha ndihmesën e saj nëpërmjet rekomandimeve që KShH-ja ka prezantuar në studimin e tij për shërbimin avokator falas.

#### **2.6 KSHH paraqit mendimet e tij lidhur me disa pjesë të Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Drejtësisë**

Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, Komiteti Shqiptar i Helsinki (KSHH) pasi u njoh me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Drejtësisë ofroi mendimet e tij për të kontribuar në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të kësaj Strategjie. Më konkretisht, mendimet dhe sugjerimet konkrete të KSHH-së u fokusuan në fushën penitenciare si edhe në disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me rritjen e aksesit dhe të transparencës së shtetit gjyqësor për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve.

Ky dokument i detajuar solli në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë çështje që kishin të bënin me qëllimin dhe objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm të Strategjisë, problematikën që karakterizon të dy fushat e lartpërmendura, si edhe mendime se cilat do të ishin ndërhyrjet strategjike dhe politikat konkrete që duhen hartuar dhe vënë në zbatim nga organet përgjegjëse shtetërore për këto dy fusha. Më tutje, KSHH paraqiti mendimet e tij konkrete lidhur me çështjet e renditura në kapitullin 3 të Strategjisë - pjesa ”Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”.

Ministria e Drejtësisë mirëpriti dhe vlerësoi këtë dokument të KSHH-së si tepër të dobishëm për përmirësimin e mëtejshëm të Strategjisë Sektoriale të MD.

### **3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE EDUKUESE NË FUSHËN E BURGJEVE**

#### **3.1 Trajnim i personelit të rolit bazë dhe stafit të sektorëve të ndryshëm të institucionit të paraburgimit në Lezhë**

Në datat 1-2 mars 2007, KShH-ja organizoi sesionin e tretë të trajnimit të personelit të rolit bazë të regjimit të brendshëm dhe përfaqësuesve të personelit civil në këtë institucion<sup>1</sup>. Qëllimi i sesionit të trajnimit ishte krijimi i një modeli të mirëmenaxhimit të sistemit të paraburgimit në vendin tonë<sup>2</sup>. Në këtë sesion ofruan ekspertizën dhe përvojën e tyre ekspertët e huaj z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij<sup>3</sup>.

Temat kryesore të trajtuara në trajnim ishin: sistemi i paraburgimit, programi ditor dhe roli i tyre në arritjen e një drejtpeshimi mes sigurisë dhe programeve sociale dhe riintegruese; zbatimi korrekt dhe sistematik i Rregullave të sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe burgjeve.

Pjesëmarrësit e vlerësuan këtë trajnim si shumë të dobishëm për punën e tyre të përditshme. Trajnimi u zhvillua në mjediset e paraburgimit në Lezhë.

#### **3.2 Mbledhje me drejtorin e përgjithshëm të Burgjeve (DPB)**

Në datën 3 mars 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i përfaqësuar nga znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh, z. Jan van den Brand dhe Z. Cees Boeij, ekspertë në fushën penitenciare, të angazhuar nga KShH-ja, morën takim me z. Saimir Shehri, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve dhe stafin e tij të ngushtë drejtues.

Në këtë takim u diskutuan: progresi i arritur me trajnimet e realizuara në sektorin e paraburgimit të institucionit në Lezhë, zhvillimet e fundit në fushën e burgjeve dhe kalimi i vendeve të paraburgimit në varësinë e DPB-së, problemet dhe shqetësimet që karakterizojnë këtë proces, hapja e institucioneve të reja të dënimit dhe masat që po merr DPB-ja për përzgjedhjen e personelit në këto institucione. KShH-ja dhe ekspertët e tij e këshilluan z. Shehri të përshpejtojë procesin e përzgjedhjes së personelit sidomos për institucionet që priten të hapen së shpejti për të planifikuar mirë trajnimin e tyre përpara se institucionet të fillojnë së funksionuari. Z. Shehri premtoi ta përshpejtojë këtë proces dhe mirëpriti e vlerësoi kontributin e KShH-së në fushën penitenciare.

#### **3.3 KShH-ja dhuron libra për të dënuarit**

Për të dhënë ndihmesën e vet në përmirësimin e kushteve të jetesës në institucionet e paraburgimit dhe në burgje, në pasurimin dhe krijimin e bibliotekave të këtyre institucioneve si edhe në arsimimin dhe formimin kulturor të personave të dënuar me

<sup>1</sup> Aktiviteti është pjesë e trajtimeve që KShH-ja po realizon gjatë periudhës 2006-2007 me administratën e institucionit të Lezhës.

<sup>2</sup> Ky sesion pune u realizua në kuadër të projektit të KShH-së "Drejtimi i paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut", financuar nga Fondi i Demokracisë dhe i Drejtave të Njeriut, Departamenti i Shtetit, ShBA.

<sup>3</sup> Drejtorë të përgjithshëm në shërbimin e burgjeve holandeze.

heqje lirie, KShH-ja dhuroi për bibliotekat e institucioneve të paraburgimit dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimit **1814 libra, botimet më të mira të letërisë vendëse dhe të huaja**<sup>4</sup>.

Pas thirrjes publike për t'iu bashkuar kësaj nisme që KShH-ja u bëri të gjitha organizatave jofitimprurëse, vendëse dhe të huaja, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime, më të u bashkuan: Zyra e Këshillit të Europës, Avokati i Popullit, UNICEF-i, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare duke dhuruar libra për institucionet e paraburgimit dhe të burgjeve. Kësaj nisme iu përgjigjën, gjithashtu, edhe disa nga shtëpitë botuese më të njohura, si: *Çabej, Omsca-1, Ombra GVG* dhe shtëpia botuese *Dudaj*. Ato dhuruan libra të ndryshëm artistikë nga fondi i tyre.

Ceremonia e dhurimit të librave Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u zhvillua në 7 mars 2007, në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës.

### **3.4 Kontributi i KShH-së në botimin e buletinit informativ “Rikthim në shoqëri”**

Nisur nga nevoja e të dënuarve dhe e administratës në institucionet e riedukimit për të pasur komunikim sistematik mes burgjeve si dhe ndërmjet të dënuarve dhe personelit të institucioneve, KShH-ja vendosi të kontribuojë për mbështetjen financiare të buletinit mujor dhe informativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve “Rikthim në shoqëri”<sup>5</sup>. Ky buletin është botuar gjatë periudhës prill 2005 - shkurt 2007. KShH-ja pasuroi përmbajtjen e këtij buletini me informacione për çështje dhe veprimtari të ndryshme ligjore me interes për personat e dënuar dhe për kontributin e dhënë nga KShH-ja në ngritjen e kapaciteteve të personelit në disa burgje të vendit. Në buletin u është dhënë hapësirë zhvillimeve në këto institucione, si dhe problemeve dhe shqetësimeve të ngritura herë pas here nga organizma të ndryshëm vëzhgues kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Buletini “Rikthim në shoqëri” ka shërbyer edhe si një dritare për të pasqyruar talentet për poezi mes të paraburgosurve dhe të dënuarve.

## **4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHTETËRORE**

### **4.1 Takime me autoritetet shtetërore**

#### **4.1.1 Përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit ftohen në takim me z. Alfred Moisiu, President i Republikës së Shqipërisë**

<sup>4</sup> Kjo nismë është realizuar në saje të mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit dhe të ambasadës amerikane në Tiranë.

<sup>5</sup> Botimi për 22 muaj i buletinit mujor “Rikthim në shoqëri” është realizuar me mbështetjen financiare të donatorit të kësaj nisme, Komitetit Suedez të Helsinkit.

Më 22 janar 2007, Presidenti i Republikës së Shqipërisë realizoi një takim me përfaqësues të shoqërisë civile, ndërmjet të cilëve edhe të KShH-së. Në takimin e zhvilluar, z. Alfred Moisiu vlerësoi rolin e shoqërisë civile në zhvillimin e demokracisë në përgjithësi dhe vëzhgimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë. Ndër të tjera, në takim u diskutua për fushatën zgjedhore, për respektimin e Kodit të sjelljes, transparencën në financimin e fushatës elektorale dhe respektimin e së drejtës së votës. Presidenti i Republikës së Shqipërisë theksoi rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe nevojën e koordinimit të punës së saj në këtë drejtim.

## **4.2 Komunikime me autoritetet shtetërore**

KShH-ja ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore, kryesisht për trajtimin e ankesave të ardhura në adresë të tij, për paraqitjen e problematikës së dalë nga vëzhgimi, për dhënien e rekomandimeve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike, për raportim lidhur me aktivitetet e realizuara nga KShH-ja etj. Komunikimet janë realizuar kryesisht me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, drejtoritë e institucioneve të riedukimit, prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme etj. Në komunikimet e KShH-së me autoritetet shtetërore vlen të përmendet komunikimi dhe bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për çështje të ndryshme të ligjit dhe të praktikës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Krahas tyre, KShH-ja ka mbajtur të informuar për hapat e ndërmarrë shtetasit që kanë paraqitur ankesa në këtë komitet.

## **5. RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E EDUKIMIT TË PUBLIKUT**

### **5.1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe e edukimit të publikut nëpërmjet medias<sup>6</sup>**

#### **5.1.1 Shkeljet e Kodit të etikës në fushatat zgjedhore– shqetësim edhe i përfaqësuesve të medias**

Në datën 22 janar 2007, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, ishte e ftuar nga televizioni *Vizion+* në një emision televiziv që trajtonte fillimin e fushatës zgjedhore dhe shkeljen e Kodit të etikës nga grupimet politike. Në këtë emision drejtorja ekzekutive e KShH-së shprehu qëndrimin dhe rolin e organizatës në vëzhgimin e zgjedhjeve.

#### **5.1.2 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ftohet të marrë pjesë në auditoriumin e BBC-së**

Në datën 27 janar 2007, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së ishte e ftuar në emisionin “Auditorium” në të cilin u trajtuan çështje të cilat kishin të bënin me zgjedhjet, fushatën zgjedhore, krizën energjetike, transparencën në financimet e fushatës elektorale të forcave politike etj.

<sup>6</sup> Gjatë periudhës janar-mars, KShH-ja ka pasur shumë prononcime në median e shkruar dhe elektronike për procesin zgjedhor dhe probleme të tij



### **5.1.3 Informimi i votuesve për të drejtën e votës dhe procedurën e ushtrimit të saj – një domosdoshmëri në kushtet e ndryshimeve të Kodit zgjedhor Vonesat në shpalljen e listave cenojnë të drejtën e votuesve**

Me qëllim sensibilizimin e votuesve lidhur me ndryshimet e kryera për listat e votimit, ankimin, procedurat e votimit, më 26 janar 2007, znj.Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, ishte e ftuar në programin e mëngjesit të NEWS- 24. Çështjet e trajtuara ishin: vonesat në shpalljen e listës së zgjedhësve dhe ndikimi i tyre në të drejtën e ushtrimit të votës; informimi i grupeve të veçanta, si i studentëve që kryejnë studimet në universitete që janë jashtë vendbanimit të tyre, i të dënuarve, i të sëmurëve etj.; e drejta e ankimit të votuesve dhe mekanizmat e ankimit në rastet e mosgjetjes së emrit në listën paraprake ose të gabimeve në të.

Brenda ditës, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe të KQZ-së u shprehën lidhur me disa shqetësime të ngritura në emisionin e mëngjesit, si: shpallja e listës së zgjedhësve, problemi i certifikatave dhe rregullat e përdorimit të tyre.

## **5.2 Konferenca për shtyp**

### **5.2.1 Komiteti Shqiptar i Helsinkit – organizata e parë jofitimprurëse që jep përfundimet e vëzhgimit të procesit zgjedhor**

Në datën 13 shkurt 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit mbajti një konferencë për shtyp për të paraqitur përfundimet kryesore të dala nga raundi i parë i vëzhgimeve të fushatës zgjedhore. Përfundimet kishin dalë nga vëzhgimi i fushatës zgjedhore të realizuar nga vëzhguesit e KShH-së në 7 rrethet kryesore të vendit: Tiranë, Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë, Vlorë, Korçë dhe Fier. Në konferencë ishte e pranishme media e shkruar dhe elektronike, e cila e reflektoi aktivitetin në shtypin e përditshëm.

Në datën 19 shkurt 2007, KShH-ja organizoi një konferencë për shtyp në të cilën paraqiti përfundimet e para të dala nga vëzhgimi i procesit zgjedhor, përfshirë këtu edhe procesin e votimit të datës 18 shkurt 2007.

Për më shumë, shih <http://ahc.org.al/kshh/zgjedhjet/raporteZGJEDHJET.html>

### **5.2.2 Konferencë për shtyp për respektimin e etikës gjatë fushatës zgjedhore**

Më 13 shkurt 2007, KShH-ja mori pjesë në një konferencë të përbashkët për shtyp me fondacionin SOROS, lëvizjen “Mjaft”, Institutin për Praktikën dhe Studimet Ligjore dhe Aleancën Gjimore për Zhvillim. Në konferencën për shtyp përfaqësuesit e shoqërisë civile tërhoqën vëmendjen për mjetet joqytetare që po përdorshin ndaj kandidatëve për zgjedhjet e qeverisjes vendore dhe cenimin e privacisë dhe të jetës familjare.

## **5.3 Publikime**

### **5.3.1 Publikimi i fletëpalosjes për procesin zgjedhor**

Në kuadër të misionit edukues dhe ndërgjegjësues të votuesve për zgjedhjet vendore të 18 shkurtit 2007, KShH-ja publikoi një fletëpalosje për procesin zgjedhor dhe të drejtat e votuesve në këtë proces. Fletëpalosjet u shpërndanë në të gjithë vendin së bashku median e shkruar të përditshme.

### 5.3.2 Publikimi i disa suplementeve

- ▶ Gjatë muajit shkurt 2007, KShH-ja publikoi, gjithashtu, katër suplemente në median e shkruar të përditshme, nëpërmjet të cilave ka dhënë informacion për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Gjuha e përdorur ishte e thjeshtë dhe e kuptueshme nga publiku i gjerë.
- ▶ Po në muajin shkurt u botua një tjetër suplement në median e shkruar të përditshme, në të cilin ishin paraqitur materiale me karakter informues në fushën e migracionit. Në këto materiale përfshiheshin pjesë nga “Strategjia kombëtare për migracionin”, pjesë nga raportet e monitorimeve të zhvilluara nga KShH-ja, informacione lidhur me lehtësimin e regjimit të vizave për Shqipërinë, si dhe informacione konsullore që mund t’u vijnë në ndihmë emigrantëve shqiptarë kudo ku ata ndodhen.

### 5.3.3 Raporti i monitorimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore<sup>7</sup>

Në kuadër të monitorimit të procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, 18 shkurt 2007, në muajin mars KShH-ja publikoi raportin e tij online për aspektet më të rëndësishme të vëzhguara. Në këtë raport është pasqyruar problematika si dhe janë trajtuar një sërë çështjesh, si: procesi parazgjedhor, fushata zgjedhore, procesi i votimit dhe ai i numërimit. Gjithashtu, në raport janë përfshirë edhe disa nga përfundimet dhe sugjerimet kryesore për përmirësimin e reformës zgjedhore dhe të administrimit të zgjedhjeve.

Për më shumë, shih faqen tonë të internetit [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

### 5.3.4 Ribotimi i librit “Si t’i bëjmë normat e zbatueshme”

Për t’u ardhur në ndihmë nevojave të administratës së burgjeve si dhe të gjithë aktorëve që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime, në muajin mars 2007, KShH-ja realizoi ribotimin në 1800 kopje të manualit “Si t’i bëjmë normat e zbatueshme”. Ky manual me karakter ndërkombëtar synon të paraqesë një përshkrim të rregullave të OKB-së për kushtet e burgjeve dhe trajtimin e të dënuarve si dhe të shpjegojë vlerën dhe kuptimin e tyre mbi politikat e burgjeve dhe punën e përditshme në këto institucione.

## 5.4 REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës janar – mars 2007, nëpërmjet **15 deklaratave publike**, KShH-ja ka reaguar kryesisht për çështje të procesit zgjedhor për zgjedhjen e organeve të qeverisjes

---

<sup>7</sup> Ky raport është realizuar në kuadër të monitorimeve të procesit zgjedhor, 18 shkurt 2007, mbështetur financiarisht nga CORDAID-i

vendore, si: respektimi i etikës gjatë fushatës zgjedhore, vonesat në ngritjen e KZQV-ve, respektimi i Kodit zgjedhor, procesi i numërimit etj<sup>8</sup>. Gjithashtu, në bashkëpunim dhe solidarizim me organizata të tjera jofitimprurëse, KShH-ja ka reaguar publikisht për shfaqjet antishqiptare dhe ksenofobe në Greqi.

## **6. VEPRIMTARI NDËRGJEGJËSUESE DHE EDUKUESE**

### **6.1 Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri**

Gjatë periudhës 14-17 Mars 2007, Shkolla e Filmit dhe Multimedias Marubi organizoi edicionin e dytë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri. Ka kaluar një vit dhe reputacioni ndërkombëtar i këtij Festivali është bërë i dukshëm në një sërë organizatash vendase dhe ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e njeriut. Realizimi i edicionit të dytë të Festivalit u mundësua edhe nga mbështetja e partnerëve si: Konsortiumi Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Utica College, UNICEF, Ambasada Gjermane, Ambasada Amerikane, Ambasada Franceze, Ambasada Italiane, Instituti Shqiptar i Medias, EUSAC, UNDP dhe OSBE.

Përzgjedhja e filmave artistikë dhe dokumentarë, edhe pse nga vende e kontinente të ndryshme, ishte mbështetur mbi tematika e problematika, të cilat prekin fenomene të ndjeshme të të drejtave të njeriut për vendin tonë siç janë: të drejtat e fëmijëve, të drejtat e grave, trafikimi i qënieve njerëzore, diversiteti etnik e kulturor, etj.

### **6.2 Fushata ndërgjegjësuere “Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të barabartë” Java kundër diskriminimit, 19-24 mars 2007**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Diskriminimit, KShH-ja ndërmoi disa veprimtari ndërgjegjësuere me brezin e ri me qëllim edukimin dhe sensibilizimin për të parandaluar rastet e diskriminimit të hapur ose të fshehtë në shoqëri.

Në datat 19-20 mars 2007, KShH-ja organizoi seminare sensibilizuese në shkollat e mesme të përgjithshme: “Aleks Buda”, “Eqrem Çabej”, “Sadik Stavileci”, në Katundin e Ri dhe “Gramoz Palushi”, në Babrru, Tiranë.

Temat kryesore të trajtuara në seminare ishin: çështje të diskriminimit në përgjithësi, të drejtat e fëmijëve dhe rastet e diskriminimit të tyre, diskriminimi racia, shfaqje të problemeve të diskriminimit në radhët e nxënësve me kultura të ndryshme, trashëgimia kulturore, diskriminimi në shkollë, pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje, funksionimi i senateve të nxënësve dhe të organizmave të tjerë të ngjashëm në edukimin e tolerancës dhe të mirëkuptimit, roli i organizatave jofitimprurëse në këtë proces etj.

Metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse e përdorur në këto veprimtari u dha mundësi nxënësve të shprehin lirisht mendimet e tyre për diskriminimin. Në kuadër të këtyre veprimtarive u morën takime me përfaqësuesit e drejtorive të shkollave në të cilat u

<sup>8</sup> Për më gjerë, shih shtojcën <http://www.ahc.org.al/DEKLARATA2007.html>

zhvilluan seminarët ku u shkëmbyen mendime lidhur me nevojën e programeve sensibilizuese për tolerancë dhe respektimin e diversitetit kulturor.

KShH-ja u dhuroi bibliotekave të këtyre shkollave disa publikime të dobishme për edukimin ligjor të të rinjve.

Në kuadër të javës kundër diskriminimit, KShH-ja zhvilloi veprimtari sensibilizuese me nxënës dhe studentë në disa shkolla të rrethëve Fier, Korçë dhe Elbasan.

*Në rrethin e Korçës* u zhvillua një seminar me nxënës të shkollës së mesme të përgjithshme “Ymer Dishnica”. Nëpërmjet një pyetësoi të përgatitur nga vetë nxënësit u mblodhën informacione për diskriminimin. Përfundimet e tij u paraqitën në seminar. Gjithashtu, vetë nxënësit kishin përgatitur ese, poezi dhe vizatime në të cilat paraqiteshin format e diskriminimit nga këndvështrimi i tyre të cilat u trajtuan edhe gjatë seminarit. Punimet më të mira u vlerësuan me çmime dhe u shoqëruan me një dhuratë simbolike.

*Në rrethin e Fierit* u zhvilluan një sërë veprimtarish sensibilizuese dhe kulturore me moton “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”. U zhvillua një orë e hapur me nxënës të shkollës private “Flatrat e Dijes” ku vetë fëmijët diskutuan për diskriminimin dhe të drejtat e tyre në familje. U organizua një sesion shkencor edhe me mësues të rrethit të Fierit në të cilin u referua për përpjekjet që po bëjnë institucionet arsimore në Fier për luftën kundër diskriminimit, si dhe u prezantua Rekomandimi 10 i Komisionit Europian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI-t) për rolin e shkollës në luftën kundër diskriminimit. Më pas u zhvilluan veprimtari kulturore nga nxënës të shkollave si dhe u përrua kabineti i traditës myzeqare, përfshirë edhe gatimin. Në këto veprimtari mori pjesë dhe stafi i KShH-së.

*Në rrethin e Elbasanit* u zhvillua një seminar me studentë të fakulteteve të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për format e diskriminimit dhe masat për parandalimin e tij. Vetë studentët realizuan një Mock Debate me temën “A ka bërë qeveria punë të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sidomos të atyre që vijnë nga komuniteti rom dhe ai egjiptian”.

Të gjitha veprimtaritë sensibilizuese të organizuara kishin si qëllim jo vetëm ndërgjegjësimin e të rinjve për luftën kundër diskriminimit, por edhe nxitjen e debatit midis vetë të rinjve<sup>9</sup>.

KShH-ja, si një organizatë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, do të vazhdojë të japë ndihmesën e vet për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për të parandaluar diskriminimin në çdo formë që të paraqitet ai.

---

<sup>9</sup> Aktivitetet u zhvilluan në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

Ekspertët që referuan në këto seminare: Florian Xhuhani - Tiranë, Mikail Sterio – Elbasan, Donika Jorgaqi – Fier, Arben Kosturi – Korçë; stafi i KShH-së: Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së dhe Etilda Saliu, juriste/koordinatore projekti; korrespondentët e KShH-së: Frederik Jorgaqi – Fier, Keti Qirinxhi – Korçë dhe Ymer Leksi - Elbasan

KShH-ja falënderon drejtoritë arsimore të rretheve Tiranë, Korçë, Fier dhe rektoratin e Universitetit të Elbasanit për bashkëpunimin e frytshëm në realizimin e këtyre veprimtarive.

Gjithashtu, falënderojmë për punën e palodhur gjithë ekspertët që punuan si dhe korrespondentët e KShH-së në rrethet përkatëse për veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të kësaj jave kundër diskriminimit në përgjithësi dhe diskriminimit racial në veçanti.

### **6.3 Tryeza të rrumbullakëta**

#### **Trajtimi i sëmundjeve ngjitëse në paraburgimet dhe burgjet shqiptare**

Më 26 janar 2007, në mjediset e hotel “Doros”, KShH-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët me objekt kryesor marrjen e masave për hartimin e një politike dhe plani konkret dhe realist veprimi për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve ngjitëse në burgje<sup>10</sup>. Organizimi i një veprimtarie të tillë ishte me interes dhe rëndësi, pasi paraburgimet dhe burgjet shqiptare po ballafaqohen me çështjen e trajtimit dhe të kurimit të sëmundjeve ngjitëse të personave të dënuar me heqje lirie. Në përfundim të tryezës, pjesëmarrësit dolën me disa nga rekomandimet kryesore të cilat iu prezantuan Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në një dokument për hartimin e politikës dhe planit të veprimit për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve ngjitëse në paraburgime dhe në burgje<sup>11</sup>.

Në këtë veprimtari morën pjesë shefat e personelit mjekësor dhe zëvendës drejtorët e të gjitha burgjeve të Shqipërisë, të qendrës spitalore të burgjeve, të institucioneve të paraburgimit 302 dhe 313 në Tiranë si edhe një përfaqësuese e DPB-së<sup>12</sup>. Në këtë aktivitet ofroi ekspertizën e tij edhe z. Jan van den Brand<sup>13</sup>.

## **7. AVOKIMI NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

### **7.1 Këshillime ligjore**

Gjatë periudhës janar-mars 2007, në adresë të KShH-së kanë ardhur gjithsej 73 ankesa dhe kërkesa për këshillim ligjor. Pjesa më e madhe e tyre ka ardhur nga persona të paraburgosur dhe të dënuar me burgim. Ankesat e tyre kanë qenë kryesisht për vendimet e gjykatës. Vihet re rritja e numrit të ankesave për shkeljen e të drejtave nga administrata e burgjeve, si dhe e ankesave për shkeljen e të drejtave nga ana e organeve të policisë. Në pjesën më të madhe të rasteve, KShH-ja u është adresuar organeve kompetente, si

<sup>10</sup> Kjo veprimtari u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri”, mundësuar financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.


<sup>11</sup> Së shpejti, KShH-ja planifikon ta publikojë këtë dokument në faqen e tij të internetit [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

<sup>12</sup> Pjesëmarrja e personave përgjegjës për shërbimin shëndetësor në DPB ishte e nevojshme, pasi ky sektor do të ketë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në hartimin e një politike dhe plani veprimi për sëmundjet infektive në sistemin penitenciar shqiptar.

<sup>13</sup> Ekspert në shërbimin e burgjeve në Holandë dhe kryetari i grupit të punës për politikën e sëmundjeve ngjitëse në institucionet penitenciare holandeze.

Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, prokurorive përkatëse të rretheve, drejtorisë së policisë etj.

**Tabela e ankesave Janar-Mars 2007:**



## 7.2 Raste të verifikuara nga KShH-ja

Përveç trajtimit të letrave dhe të ankesave të qytetarëve, KShH-ja ka verifikuar raste në të cilat është pretenduar për shkeljen e të drejtave të njeriut.

- ▶ Pas një njoftimi të marrë në datën 18 janar 2007, se i dënuari A.S., i cili vuan dënimin në burgun e Peqinit, ishte futur në grevë urie, një grup vëzhguesish të KShH-së ndërmorën një mision verifikimi në këtë institucion. Shkak i grevës së urisë së të dënuarit A.S. ishte kundërshtimi i vendimit gjyqësor si i padrejtë dhe i mbështetur në deklarime të rreme dhe të manipuluar. Juristët vëzhgues të KShH-së e këshilluan të dënuarin për mundësitë ligjore për ankimimin e vendimit gjyqësor.
- ▶ Bazuar në një ankesë të ardhur nëpërmjet linjës telefonike, më 25 janar 2007, një grup vëzhguesish të KShH-së realizuan një vëzhgim në burgun e Rrogozhinës dhe morën takim me të dënuarin E.A. për të cilin pretendohet se mbi të ishte ushtruar dhunë dhe se ishte keqtrajtuar nga personeli me uniformë të burgut. Për shkak të gjendjes së rëndë psikologjike ai kishte tentuar të vriste veten. Nga takimi me vetë të dënuarin dhe me shefin e regjimit rezultoi se i dënuari kishte tentuar të priste damarët me qëllim vetëvrasjen për shkak të gjendjes së rëndë të depresionit.
- ▶ Në datat 31 janar dhe 5 shkurt 2007, në adresë të KShH-së kanë ardhur ankesa telefonike nga të dënuar të burgut të Peqinit. Objekti i përbashkët i ankesave të tyre ka qenë ushtrimi i dhunës dhe keqtrajtimi i të dënuarit A.Q. nga ana e personelit me uniformë të burgut të Peqinit. Në ankesat e tyre ata pretendonin se i dënuari A.Q. ndodhej në gjendje të rëndë shëndetësore për shkak të dhunës së ushtruar. Për

verifikimin e kësaj ngjarjeje, KShH-ja vuri në dijeni menjëherë Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan. Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan nisi menjëherë procedimin penal për hetimin dhe verikimin e kësaj ankese dhe rezultoi se ngjarja nuk ishte e vërtetë.

## **8. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS**

### **8.1 Ngritje e kapaciteteve të KShH-së**

▶ Në datën 23 shkurt 2007 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare organizoi trajnimin njëditor me temë **‘Roli i avokatit në zbatimin e ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’**. Qëllimi i trajnimit ishte njohja e punonjësve të praktikës me ligjin kundër dhunës në familje, probleme të teorisë dhe praktikës. Të ftuar në trajnim ishin përfaqësues të institucioneve shtetërore, të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas, avokatë. Përfaqësuese e KShH-së ishte zj. Klesta Alikaj.

▶ Pas akreditimit të vëzhguesve nga KQZ-ja, më 27 janar 2007, KShH-ja zhvilloi trajnimin e tyre për çështje të tilla, si: Kodi zgjedhor dhe ndryshimet e tij, udhëzimet e KQZ-së, metodologjia e vëzhgimit të procesit parazgjedhor dhe zgjedhor, e respektimit të Kodit të sjelljes, mënyra e raportimit. Pjesë e trajnimit ishin: roli i vëzhguesit, cilësitë e tij, mënyra e paraqitjes së vërejtjeve në komision në rast nevojë dhe raportimi i rezultateve të vëzhgimit. Në këtë trajnim u ftuan dhe morën pjesë përfaqësues të misionit të vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it që ndodhen në Shqipëri për të monitoruar zgjedhjet vendore të 2007-s.

Në vijim të procesit trajnues, KShH-ja realizoi trajnime për korrespondentët e tij nëpër rrethe, si dhe për vëzhguesit e angazhuar për vëzhgimin e fushatës zgjedhore për aspekte të veçanta të saj, për çështje më specifike dhe konkrete.

▶ Në datën 26 mars 2007, OSBE-ja, në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe Qendrën për Nisma Ligjore, organizuan trajnimin për ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe problemet në praktikë. Grupi i synuar i këtij trajnimi ishin avokatë të cilët punonin në këtë fushë. Nga KShH-ja, në këtë trajnim morën pjesë E.Saliu, juriste dhe E.Sefa, juriste.

## **9. RRITJA E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE DHE AKTORËT SHTETËRORE**

### **9.1 Memorandum bashkëpunimi për monitorimin e progresit të integritit european të Shqipërisë**

Në datën 26 shkurt 2007, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë-SOROS, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare dhe Qendra Europiane nënshkruan së bashku me Ministrinë e Integritit memorandumin e bashkëpunimit për monitorimin e marrëdhënieve BE-Shqipëri në kuadër të procesit të

integritet europian<sup>14</sup>. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të dyja palët shprehën angazhimin e tyre për nxitjen e monitorimit të shoqërisë civile në procesin e integritet europian të vendit. Bashkëpunimi i strukturave qeveritare me ato joqeveritare në kuadrin e përpjekjeve për integritet europian të Shqipërisë është rekomanduar edhe nga ana e Komisionit Europian.

## **9.2 Mbledhja e Asamblesë së Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut (RrBDNj)**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i përfaqësuar nga znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh, mori pjesë në Mbledhjen e Asamblesë së Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut, e cila u mbajt më 10 mars 2007, në Shkup, Maqedoni.

Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte të mblidhte së bashku pjesëmarrës nga Bosnja & Hercegovina, Kroacia, Serbia, Bullgaria, Shqipëria dhe Maqedonia, anëtarë të Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut në Asamblenë e Përgjithshme të këtij rrjeti.

Në mbledhje prezantuan ekspertë të huaj dhe vendorë, përfaqësues të organizatave anëtare të RrBDNj-së. Pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht për rolin e RrBDNj-së në të ardhmen. Asambleja zgjodhi komitetin drejtues të RrBDNj-së, kryetarin e këtij komiteti dhe tre anëtarë të komitetit vlerësues, të cilët do të vlerësojnë projektpropozimet e ardhura nga organizatat anëtare të RrBDNj-së. Znj. Edlira Papavangjeli u zgjodh anëtare e këtij komiteti.

## **9.3 Takim i vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë për procesin zgjedhor**

Në kuadër të vëzhgimit të procesit elektoral për zgjedhjet e qeverisjes vendore, 18 shkurt 2007, në datën 15 shkurt, KShH-ja mori pjesë në një takim me përfaqësues të delegacionit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Përveç KShH-së, në takim morën pjesë përfaqësues të tjerë të vëzhguesve vendorë në Shqipëri. Disa nga problemet e diskutuara në takim kishin të bënin me interesin e votuesve për listat e zgjedhësve, komisionet zgjedhore etj.

## **10. PROJEKTE TË REJA**

Në muajin janar 2007 ka filluar zbatimi i projektit “Monitorimi dhe raportimi i progresit të marrëdhënive BE-Shqipëri”, financuar nga SOROS-i. Periudha e zbatimit të projektit është janar-dhjetor 2007. Qëllimi i tij është rritja e transparencës publike lidhur me procesin e integritet europian të Shqipërisë, rritja e ndërgjegjësimit dhe e përgjegjshmërisë së institucioneve shtetërore për rolin e tyre në këtë proces nëpërmjet monitorimit të pavarur, objektiv dhe profesional të masave të marra dhe progresit të arritur nga Shqipëria në drejtim të realizimit të Programit të Partneritetit Europian.

Në kuadër të projektit, fondacioni SOROS, në bashkëpunim me KShH-në, Institutin e Studimeve Ndërkombëtare dhe Qendrën Europiane<sup>15</sup>, përmes identifikimit të mangësive

<sup>14</sup> Ky memorandum bashkëpunimi realizohet në kuadër të projektit “Monitorimi dhe raportimi i progresit të marrëdhënive BE-Shqipëri” i cili do të zbatohet nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë-SOROS, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare dhe Qendra Europiane.

<sup>15</sup> Ky projekt do të zbatohet në bashkëpunim ndërmjet katër organizatave të sipërpërmendura.



ligjore dhe problemeve kryesore synojnë të ofrojnë opionencë konstruktive në fushat ku do të shtrihet monitorimi me qëllim që të kontribuojnë në përshpejtimin e afrimit të Shqipërisë në familjen europiane. Fushat kryesore të monitorimit do të jenë zgjedhjet, minoritetet, sistemi gjyqësor, sistemi i paraburgimit dhe i burgjeve etj. Për më shumë lidhur me objektivat dhe rezultatet që priten, vizitoni adresën web të KShH-së: <http://ahc.org.al/kshh/projektet%202004.html>

## **11. BOTIME QË DO TË VIHEN NË QARKULLIM SË SHPEJTI**

### **11.1 Studim i politikave për minoritetet dhe strategjitë e financimit në Shqipëri**

KShH-ja sjell për lexuesin një studim lidhur me politikat dhe veprimet e të gjithë aktorëve shqiptarë dhe të huaj që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e respektimit të të drejtave të komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Studimi synon t'i japë lexuesit dhe organizatave/individëve që punojnë për minoritetin rom dhe komunitetin egjiptian, më shumë informacion dhe një bazë të dhënash për projektet dhe programet që janë zbatuar dhe po zbatohen për këto grupe.

### **11.2 Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës**

Në kuadër të veprimtarisë në fushën e minoriteteve, KShH-ja zbatoi projektin “Monitorimi i ushtrimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës” i cili u zbatua gjatë periudhës janar-dhjetor 2006. Qëllimi i projektit ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në nivel vendor dhe evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre. Baza e zbatimit të tij ka qenë anketimi i qytetarëve dhe i administratës së bashkisë së Korçës.

Të gjitha përfundimet e dala nga anketimet e qytetarëve dhe të administratës së bashkisë së Korçës u diskutuan në një tryezë të rrumbullakët të organizuar në qytetin e Korçës dhe janë përfshirë në botimin “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës”.

### **11.3 Botime të KShH-së në fushën e burgjeve**

Gjithashtu, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2006, në përfundim të vëzhgimeve të kryera në vendet e paraburgimit, KShH-ja botoi raportin përfundimtar “Respektimi i të drejtave të personave në vendet e paraburgimit”. Ky raport paraqet përfundimet e dala nga vëzhgimet, gjetjet kryesore dhe rekomandimet e KShH-së për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vendet e paraburgimit.

### **11.4 Raporti i të drejtave të Njeriut për vitin 2006**

Gjatë muajit Prill 2007, KSHH do të publikojë raportin e të Drejtave të Njeriut për vitin 2006.